



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

**Nr. 169 Datë 18.12.2012**

**PËR  
MIRATIMIN E SKEMËS SË PËRLLOGARITJES SË KAPACITETIT  
TOTAL TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe pikës 4 paragrafi i parë i Rregullave të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi, miratimin e skemës së përllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

Proçedura që ndiqet nga ana e shoqërisë OST sh.a dhe nga çdo TSO e rajonit, bazuar në Udhëzuesin Operacional të ENTSO-e, për llogaritjen e kapaciteteve transmetuese ndërkufitarë është si më poshtë:

- 10 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndërmjet TSO-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit, dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementet jashtë pune) për periudhën e konsideruar,
- 5 dite para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC që rezultojnë nga plotësimi i kriterit N-1 të zbatuar për çdo zone kontrolli,
- 2 dite para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC për çdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhje të vlerave të llogaritura, dhe nëse palët nuk

arrijnë të bindin njëra – tjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë skemën e përlllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit. (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a, mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

*VENDIMIN*

*Nr. 169 Datë 18.12.2012*

**PËR  
MIRATIMIN E SKEMËS SË PËRLLLOGARITJES SË KAPACITETIT  
TOTAL TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Sokol Ramadani</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkëlqim Bozgo</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____

*Skema e Përlllogaritjes së Kapacitetit Total të Transmetimit së Energjisë  
Elektrike*

